

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK



“GJYKIMI NË MUNGESË

(Aspekte krahasuese në mes Kosovës, Shqipërisë dhe Italisë)”

(Punim masteri)

Mentori:

Prof.Dr.Azem Hajdari

Kandidatja:

Ilira Aliu

Prishtinë

2024

ABSTRAKT

Në botën bashkëkohore ku kemi të bëj me shtete demokratike në të cilat vlejné parimet themelore të së drejtës dhe në frymën e zhvillimit të mëtutjeshëm të të drejtave të njeriut, çështja e gjykimit në mungesë paraqet një çështje specifike dhe shumë të rëndësishme që sfidon dy drejtimet kryesore të procedurës penale. Gjykimi në mungesë është një mjet në dispozicion të efikasitetit të procedurës ndërsa është kontravers përse i përket realizimit të të drejtave të të pandehurit në procedurë.

Ky punim synon që të vë në pah dobritë e gjykimit në mungesë siç janë: realizimi i procedurës në rastet kur i pandehuri qëllimisht i shmanget procedurës dhe sigurimi i palës së dëmtuar në realizimin e drejtësisë e poashtu të hedh dritë edhe mbi procedurat apo vështërsitë e zbatimit të tij dhe vështirësitë e ekzekutimit të dënimeve të shqiptuara në mungesë të të pandehurit si dhe gjithashtu synon që të adresoj shqetësimet që paraqiten ndaj procedurës së tillë në aspekt të mosrealizimit të të drejtave të të pandehurit dhe paraqitja e gjykimeve arbitrare dhe mundësia e manipulimeve.

Duke qenë se tema trajtohet në aspekt komparativ, synohet që të gjenden edhe specifikat më të mira për zbatimin e gjykimit në mungesë në raport me shtetet e ndryshme të cilat janë marrë si model krahasues, e njëkohësisht hapsirë do t'i kushtohet edhe mangësive që kanë legjislacionet e shteteve për zbatimin e gjykimit në mungesë.

Relevanca e trajtimit të këtij punimi qëndron pikërisht në faktin se Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës që ka hyrë në fuqi në vitin 2023 ka paraparë edhe gjykimin në mungesë si një nga risitë më të mëdha të tij dhe sigurisht se në zbatimin praktik i njëjti do të ketë problematikat e veta nëse mungon trajtimi teorik i tij andaj ky punim do të mundohet që sado pak t'i kontriboj trajtimit të kësaj teme. Ndërsa shtetet krahasuese, Shqipëria dhe Italia janë zgjedhur për shkak se ato njëkohësisht përfaqësojnë legjislacione të përafërta më ato të Kosovës por megjithatë të njëjtat kanë shumë specifika dalluese, që në raste të caktuara mund të shërbejnë si model apo si shembull për t'u ndjekur, të cilat do të shihen gjatë këtij punimi.

Ky punim do të realizohet me aplikimin e metodave bashkëkohore si metoda analitike, metoda krahasimore, metoda historike si dhe metoda e studimit të rasteve gjyqësore.

Përmes metodës analitike është arritur të analizohet kuptimi i gjykimit në mungesë dhe kushtet për realizimin e tij në kuadër të legjislacionit penal në fuqi për Kosovën, Shqipërinë dhe Italinë.

Përmes metodës krahasimore është arritur që të fitohen rezultate konkrete dhe thelbësore për realizimin e këtij punimi sepse kemi krahasuar procedurat për zbatimin e gjykimit në mungesë, kushtet për zbatimin e tij, mënyra e apelimit të vendimeve të marra në mungesë dhe specifikat e tjera të cilat legjislacionet e këtyre vendeve veç e veç i përmbajnë.

Përmes metodës historike është arritur që të shpjegohet prejardhja e gjykimit në mungesë dhe poashtu edhe historia e paraqitjes së tij në secilin nga tri vendet model duke u bazuar në legjislacionin që këto vende kanë pasur dhe arsyet e paraqitjes së tij në periudha të caktuara.

Përmes metodës së studimit të rasteve është arritur që të shihet zbatimi në praktikë i zhvillimit të gjyqimit në mungesë të të pandehurit dhe rezultatet që kanë dhënë këto gjykime. Pjesa më e madhe e rasteve përfshijnë aktgjykime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut e cila në shumë raste ka vendosur standarte përsa i përket zbatimit të gjyqimit në mungesë nga dy shtetet model, Italia dhe Shqipëria.

Ky punim shkencor trajton gjykimin në mungesë në aspekt krahasues ndërmjet tri shteteve: Kosovës, Shqipërisë dhe Italisë, duke u fokusuar kryesisht kushtet që kërkohen për zbatimin e gjyqimit në mungesë dhe në përcaktimin e veçorive dhe dallimet që përmban legjislacioni i këtyre vendeve të cilat edhe pse të afërta për nga hapsira territoriale, janë tejet të ndryshme dhe secila has në problematikat e veta të zbatimit praktik.

Punimi përmban pjesën hyrëse si një pjesë sqaruese në lidhje me përmbajtjen, objektin e studimit, metodat të cilat janë përdorur për të shtjelluar temën dhe strukturën e punimit. Ndërsa është e ndarë në katër kapituj të cilët përmbajnë titujt përkatës.

Kapitulli i parë synon të trajtoj çështjen e gjyqimit në mungesë në Kosovë përgjatë kohës, konkretisht duke filluar nga viti 1999, si një kohë kur Kosova fillon hapat e saj në pavarësimin legjislativ. Ky kapitull tutje vazhdon të trajtoj rrjedhën e legjislacionit të Kosovës ndër vite por në masë më të madhe fokusohet në trajtimin e gjyqimit në mungesë sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të vitit 2022 me të gjitha specifikat që përmban ky kod në lidhje me këtë temë.

Kapitulli i dytë kryesisht trajton çështjen e gjyqimit në mungesë sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë, duke u mundur të përcaktoj sa më qartë kushtet për zbatimin e gjyqimit në mungesë, rastet se kur mund të zbatohet i njëjti, rastet kur zbatimi i tij nuk është i lejuar etj. Ky kapitull shoqërohet edhe nga analizimi i disa vendimeve në lidhje me gjykimin në mungesë të GJEDNJ-së dhe gjykatave të vendit, për të sqaruar nocione, kriteret e standard në lidhje me temën që po trajtohet.

Ngjashëm edhe kapitulli i tretë paraqet një trajtim të shkurtër por që përmban mjaft specifika për gjykimin në mungesë në Republikën e Italisë. Italia si vend që bënë pjesë tash e disa kohë në Këshillin e Evropës dhe si nënshkruese e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në këtë punim është trajtuar edhe në kuptim të vendimeve të GJEDNJ-së lidhur me gjykimin në mungesë andaj ky kapitull paraqet një segment mjaft interesant të punimit, sepse në një mënyrë na bënë të njohura edhe kriteret dhe specifikat e përcaktuara nga GJEDNJ lidhur me temën që trajtohet.

Kapitulli i katër është ai që më së shumti vë fokusin në aspektin komparativ. Pra, në këtë kapitull mund të shohim se si me të vërtetë secili nga këto shtete në rregullativat e tyre ligjore kanë paraparë këtë çështje mjaft delikate dhe kemi mundësi të përcaktojmë se cilat zgjidhje ligjore janë më të përshtatshme, më të drejta apo anasjelltas. Këtu kemi mundësi të shohim dallimet dhe të përbashkëtat e shteteve të krahasuara në lidhje me gjykimin në mungesë.

Vlenë të theksohet se punimin në përgjithësi e karakterizon tendenca për të vlerësuar se sa normative ligjore e shteteve është në përputhje me realizimin e të drejtave të të pandehurit dhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë dhe në fund përban edhe vlerësimet në lidhje me dobinë apo të metat që ka në përgjithësi gjykimi në mungesë.

